



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 74

2 korrik

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 387, datë 27.6.2012	Për rritjen e pensioneve.....	3443
Urdhër i MD nr. 248/4, datë 22.6.2012	Për disa shtesa në urdhrin nr. 248, datë 7.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “ <i>One Stop Shop</i> -sistemi i noterisë””	3445
Vendim i GJK nr. 37, datë 13.6.2012	Me objekt: 1. Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën, i ndryshimeve të pikës 4 të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, të bëra nga VKM nr. 602, datë 23.07.2010 dhe VKM nr. 870, datë 18.06.2008; 2. Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën, i ndryshimeve të pikës 4 të VKM nr. 31, datë 20.01.2001, të bëra nga VKM nr. 604, datë 23.07.2010; VKM nr. 603, datë 23.07.2010; VKM nr. 871, datë 18.06.2008 dhe VKM nr. 872, datë 18.06.2008.....	3447
Vendim i AMF nr. 76, datë 22.6.2012	Për miratimin e dhënies së licencës për ushtrim veprimtarie sigurimi për klasat e jo-jetës.....	3454

VENDIM
Nr. 387, datë 27.6.2012

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 4 për qind të:

a) pensione të caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensione të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensione të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994 të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë me nenin 33 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna me nenet 38, 39 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensione të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr. 8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar dhe trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues sipas ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”;

f) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetëseve dhe polubarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;



h) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr. 10 139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.”.

2. Rritjen, në masën 5 për qind, të pensioneve të caktuara në përputhje me ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritjen, sipas përcaktimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1.7.2012 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit të jetë deri më 30.6.2012, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2012 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 11 562 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë në muaj dhe më shumë se 23 123 (njëzet e tri mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë në muaj.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2012 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 7 841 (shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë në muaj, por jo më shumë se 11 562 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve dhe të ardhurave, të caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe me ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, me datë fillimi deri më 30.6.2012, përfshi edhe këtë datë, edhe pas rritjes së pensionit të caktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010 “Për rritjen e pensioneve” dhe nr. 17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

7. Kompensimin e çmimeve, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse” dhe nr. 471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, do ta marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi nga 1.7.2012 e në vazhdim.

8. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të

pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010 “Për rritjen e pensioneve” dhe nr. 17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, do ta marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi nga 1.7.2012 e në vazhdim, me kusht që shumta e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë:

a) deri në 13 212 (trembëdhjetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi;

b) deri në 12 712 (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 8 531 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Pas datës 1.7.2012 të ardhurat minimale:

a) të personave që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jenë më të ulëta se 13 712 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj;

b) të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jenë më të ulëta se 8 731 (tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë në muaj dhe më të larta se 11 762 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë në muaj.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 602 milionë lekë, përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Kontingjencës, të parashikuara në buxhetin e shtetit të vitit 2012 dhe ndahen:

a) për mbulimin e pagesave të pensioneve, në shumën 1 586 milionë lekë;

b) për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga “Posta Shqiptare” sh.a., në shumën 16 milionë lekë.

11. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe “Posta Shqiptare” sh.a. për të nxjerrë udhëzimet teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR

Nr. 248/4, datë 22.6.2012

PËR DISA SHITESA NË URDHRIN NR. 248, DATË 7.6.2012 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE, PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK “ONE STOP SHOP-SISTEMI I NOTERISË””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,



URDHËROJ:

1. Në tekstin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-sistemi i noterisë”, bashkëlidhur urdhrit nr. 248, datë 7.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë, bëhen këto ndryshime:

- a) Në nenin 12, shprehja “të këtij neni” zëvendësohet me shprehjen “të nenit 11”.
- b) Pas nenit 12, shtohen nenet 12/1 dhe 12/2, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 12/1

Kërkesë vetëm për informacion të përditësuar të kartelës

Noteri mund të paraqesë pranë ZRPP-së edhe vetëm kërkesë për informacion të përditësuar të kartelës, pa kërkuar leje veprimi të mëtejshme. Në këtë rast, ZRPP-ja jep informacionin e kërkuar, pa rezervuar të drejtën e tjetërsimit për një periudhë prej 30 ditësh kalendarike.

Neni 12/2

Përlllogaritja e tatimit

1. Në paraqitjen e kërkesës për ofrimin e shërbimit, noteri njofton ZRPP-në edhe për vlerën e kontratës, me qëllim përlllogaritjen nga operatori i ZRPP-së të vlerës së tatimit mbi të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë, që do të paguhet nga individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, në llogarinë e noterit.

2. Operatori i ZRPP-së, në momentin që ofron shërbimin e kërkuar nga noteri, për dhënien e informacionit zyrtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për individët dhe institucionet, e njofton atë edhe për vlerën e tatimit mbi të ardhurat që duhet të paguajë individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, në llogarinë e noterit.

3. Pas lidhjes së kontratës për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme dhe kalimit të vlerës së tatimit mbi të ardhurat në llogarinë e noterit, ky i fundit derdh tatimin në llogarinë bankare të ZRPP-së dhe paraqet dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit në ZRPP.

4. ZRPP-ja, pasi merr dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit, vepron në përputhje me udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar, duke bërë dhe kalimin e tatimit mbi të ardhurat për llogari të organeve tatimore.”.

2. Ngarkohen noterët dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri, si dhe njoftimin e tij pranë të gjithë noterëve dhe zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përfshihen brenda fushës së veprimit të kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM
Nr. 37, datë 13.6.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.01.2012, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 53/28 Akti, që i përket:

SUBJEKT KËRKUES: Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara (KKPAK)

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: 1. Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën, i ndryshimeve të pikës 4 të VKM nr. 277, datë 18.06.1997, të bëra nga VKM nr. 602, datë 23.07.2010 dhe VKM nr. 870, datë 18.06.2008;

2. Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën, i ndryshimeve të pikës 4 të VKM nr. 31, datë 20.01.2001, të bëra nga VKM nr. 604, datë 23.07.2010; VKM nr. 603, datë 23.07.2010; VKM nr. 871, datë 18.06.2008 dhe VKM nr. 872, datë 18.06.2008.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 16, 17, 18, 59, 131/c, 134/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Berberin, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të subjektit kërkuar dhe subjektit të interesuar dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me ligjin nr. 8098, dt. 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit” (ligji 8098/1996), ligjin nr. 8626, dt. 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (ligji 8626/2000) dhe ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (ligji 9355/2005), Kuvendi i Shqipërisë iu ka njohur personave me aftësi të kufizuar të drejtën për të përfituar një pagesë shtesë për shkak të paaftësive të tyre fizike. Sipas neneve 5 të ligjit 8098/1996, dhe 15 të ligjit 8626/2000, *supra*, vlera konkrete e kësaj pagese përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Në bazë të VKM-së nr. 277, datë 18.06.1997 (pika 4) dhe VKM-së nr. 31, datë 20.01.2001 (pika 4), Këshilli i Ministrave iu ka njohur të drejtën personave me aftësi të kufizuar të gëzojnë një pagesë mujore në masën e 70% të pagesës minimale shtetërore.

2. Si rezultat i ndryshimeve të bëra nga Këshilli i Ministrave me anë të disa VKM-ve (përkatësisht nr. 870, datë 18.06.2008, nr. 602, datë 23.07.2010, nr. 871, datë 18.06.2008, nr. 872, datë 18.06.2008, nr. 603, datë 23.07.2010, nr. 604, datë 23.07.2010), kjo pagesë është përcaktuar aktualisht në vlerën: 9 800 (nëntë mijë e tetëqind) lekë në muaj e indeksuar me indeksin e çmimeve të konsumit (për të verbrit) dhe 8 700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj e indeksuar me indeksin e çmimeve të konsumit (për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë).



3. *Subjekti kërkues* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndryshimet e pikës 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.06.1997 dhe pikës 4 të VKM-së nr. 31, datë 20.01.2001, si pasojë e të cilave vlera e pagesës indeksohet mbi bazën e indeksit të çmimeve të konsumit, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike.

4. Në mbështetje të këtij pretendimi, në mënyrë të përmbledhur, subjekti kërkues ka parashtruar se indeksi i pagesës mbi bazën e pagës minimale, përpara ndryshimeve, përbënte një përmirësim të standardit të jetesës për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar. Lidhja e rritjes së pagesës me çmimet e konsumit do të thotë një rritje zero, një përkeqësim i jetesës dhe humbje e standardit të fituar, duke cenuar edhe nenin 59, pika “f” të Kushtetutës që parashikon përmirësimin në vazhdimësi të jetesës së personave të paaftë, si një nga objektivat socialë të shtetit. Këto ndryshime, sipas subjektit kërkues, kanë rritur pasigurinë dhe shqetësimin e personave me aftësi të kufizuar për të ardhmen e pagesave të tyre.

5. *Subjekti i interesuar*, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar me shkrim kundërshtimet e tij si vijon:

5.1 Subjekti kërkues nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese pasi: a) nuk plotëson kriterin “vetjak” të interesit për të vepruar, që ka të bëjë me titullaritetin e të drejtave të personave që do të prekeshin nga vendimet objekt kundërshtimi; b) kërkesa e paraqitur prej tij nuk specifikon shkeljet konkrete dhe argumentet që do të justifikonin interesin për të iniciuar kontrollin kushtetues të normave;

5.2 Ndryshimi i mënyrës së përlllogaritjes së pagesës nuk cenon parimin e sigurisë juridike, pasi aktet normative të Këshillit të Ministrave nuk mund të jenë të përhershme e të pandryshueshme;

5.3 E drejta e përfitimit të masës së shpërblimit nuk është automatike, nuk është rezultat i një kontributi të mëparshëm, ndaj detyrimi për ofrimin e këtij përfitimi rëndon mbi buxhetin e shtetit;

5.4 Referuar situatës ekonomike aktuale, e cila paraqitet jo e favorshme, Këshillit të Ministrave ka marrë masat paraprakisht për të përshtatur pagesën, duke u kujdesur të kontrollojë shpenzimet buxhetore;

5.5 Subjekti kërkues nuk ka shteruar ankimin administrativ ndaj akteve normative që kundërshtohen;

5.6 E drejta për të pasur një indeksim të masës së përfitimit në raport me pagën minimale, nuk është parashikuar në nivel ligjor apo kushtetues, për rrjedhojë, ajo nuk mund të cilësohet si një e drejtë themelore e individit;

5.7 Subjekti kërkues nuk ka arritur të provojë se ndryshimet e kundërshtuara do të sjellin detyrimisht përkeqësim të jetesës së personave të verbër, paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

II

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka ngritur pretendimin se subjekti kërkues nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kërkimin për antikushtetutshmëri të dispozitave, objekt i këtij kontrolli kushtetues, për arsye të mungesës së interesit në këtë çështje dhe mosparaqitjes së shkeljeve konkrete në kërkesë.

7. Gjykata e ka vlerësuar çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e procesit të kontrollit kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Organizatat janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në

mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre.

8. Sipas Gjykatës, vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën, duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial, dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 43, datë 06.10.2011; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) është një organizatë “ombrellë” e organizatave kombëtare të personave me aftësi të kufizuara (Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Para dhe Tetraplegjikëve, Shoqata Kombëtare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë, Shoqata në Ndihmë të Handikapatëve Mendorë të Shqipërisë), regjistruar si person juridik me vendimin gjyqësor nr. 1686, datë 19.05.2006. Si e tillë ajo përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, duke pasur parasysh se është krijuar si një organizatë që bashkon disa shoqata dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Qëllimi i kësaj organizate, sipas nenit 5 të statutit, është “*t’u sigurojë njerëzve me aftësi të kufizuara realizimin më të mirë dhe në dobi të tyre të të drejtave themelore të njeriut, nëpërmjet përfshirjes së tyre në hartimin e politikave, legjisacionit dhe zbatimin e tyre në Republikën e Shqipërisë....KKPAK angazhohet në mënyrë të posaçme për të kontribuar në zgjidhjet e problemeve të karaktereve të veçanta mbi bazën e kërkesës së shoqatës përfaqësuese*”. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se KKPAK është një organizatë që përfaqëson interesat dhe mbrojtjen e drejtat kushtetuese të të gjithë personave me aftësi të kufizuara dhe, në këtë cilësi, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka një interes të kualifikuar që lidhet drejtpërsëdrejti me zbatimin e akteve normative që kundërshtohen përpara Gjykatës.

10. Referuar neneve 22 dhe 29 të statutit, Gjykata vëren se këshilli drejtues është organi që mbart personalitetin juridik të KKPAK, i cili autorizon Presidentin apo një grup anëtarësh të vetë këshillit që të hyjë në marrëdhënie me të tretët. Në bazë të vendimit nr. 1, datë 24.12.2004 të Asamblesë së Përgjithshme të KKPAK, këshilli drejtues ka zgjedhur unanimitisht z. S. Tafaj si Kryetarin e KKPAK. Duke pasur parasysh nenet përkatëse të statutit, z. S. Tafaj i ka tagrat për të përfaqësuar KKPAK, si kryetar i saj.

11. Subjekti kërkuës pretendon në thelb se ndryshimet e pasqyruara në VKM-të, objekt i këtij kontrolli kushtetues, cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuar, të cilat kjo organizatë ka për mision që t’i mbrojë. Aktet normative, të cilat kundërshtohen nëpërmjet kërkesës së paraqitur, përmbajnë ndryshime të formulës për përllogaritjen e pagesës mujore që iu takon personave me aftësi të kufizuar dhe, si të tilla, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e jetesës për këtë kategori personash.

12. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, bazuar në statutin, aktin e themelimit dhe natyrën e veprimtarisë së organizatës, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimtarisë ligjore për të cilën ajo është krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej saj.

13. Në këto rrethana, Gjykata çmon se subjekti kërkuës legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës në funksion të kontrollit kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi.

14. Për rrjedhojë, pretendimi i përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, në lidhje me legjitimitimin e kërkuësit, është i pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike



15. Subjekti kërkues ka pretenduar se ndryshimet në lidhje me mënyrën e llogaritjes së pagesës mujore, që jepet nga shteti për shkak të aftësisë fizike të kufizuar, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Për të mbështetur këtë pretendim, ai argumenton se këto ndryshime kanë sjellë një përkeqësim të jetesës së personave me aftësi të kufizuar që ai përfaqëson dhe kanë dëmtuar besueshmërinë e qytetarëve të shteti.

16. Gjykata, në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 18.06.2010; nr.24, datë 12.11.2008; nr.9, datë 26.02.2007*).

17. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 02.11.2005). Në këtë pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Jo çdo masë me efekte negative që merr ligjvënësi për subjektet e ligjit është cenim i një të drejte të garantuar me Kushtetutë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta, të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme, nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 19.03.2008*).

18. Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kjo Gjykatë nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrihen argumente bindëse, për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.07.2008*).

19. Në rastin konkret, pagesa mujore për të cilën bëhet fjalë është një e drejtë e fituar e personave me aftësi të kufizuar nga ligji nr. 8098/1996 (neni 5) dhe ligji nr. 8626/2000 (neni 15). Kjo e drejtë ka karakter ekonomiko-social dhe synon t'u garantojë shtetasve mjete të përshtatshme për të përballuar nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, sëmundjeve, apo invaliditetit, që çojnë në një situatë papunësie të padëshiruar. Sipas dispozitave përkatëse të këtyre ligjeve, parashikohet se të verbrit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla, vlera monetare e së cilës përcaktohet nga Këshilli i Ministrave (KM). Ky i fundit, si organi kompetent që vendos kriteret për llogaritjen monetare të masës së pagesës, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga neni 5 i ligjit nr. 8098/1996 dhe neni 15 i ligjit nr. 8626/2000, ka përcaktuar mekanizmin për përlllogaritjen e kësaj pagese..

20. Përpara ndryshimeve, objekt shqyrtimi, pagesa përlllogaritej në vlerën e 70% të pagës minimale shtetërore. Me anë të VKM-së nr. 870 dhe VKM-së nr. 871 të datës 18.06.2008, është përcaktuar masa e përfitimit për shkak të verbërisë, për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në 8700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indekshej, çdo vit me ritmet e rritjes së pagës minimale shtetërore.

21. Pas disa ndryshimeve të mëtejshme me anë të disa VKM-ve, ndërmjet të cilave VKM-të nr. 602, nr. 603 dhe nr. 604 të datës 23.07.2010, është përcaktuar se: “masa e përfitimit për shkak të verbërisë, është 9 800 (nëntë mijë e tetëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet me indeksin e çmimeve të konsumit”, ndërsa “masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8700 (tetë mijë e shtatëqind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me indeksin e çmimeve të konsumit”. Nisur nga çka më sipër, vërehet se, për këto kategori personash me aftësi të kufizuara, kriteret ligjore për përcaktimin e pagesës mujore (referuar edhe si masa e përfitimit), që ligji iu ka njohur, kanë ndryshuar në 2008 dhe më pas në 2010, ndryshime të cilat janë reflektuar dhe në përlllogaritjen e vlerës monetare të kësaj pagese.

22. Gjykata vëren se pagesa mujore që iu jepet të verbërve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, për shkak të paaftësisë fizike të tyre, përfitohet pavarësisht nga mosha, shkalla e paaftësisë dhe të ardhurat e tjera që paguhen nga shteti. Gjithashtu, kjo pagesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie (neni 5 i ligjit nr. 8098/1996; neni 4 i VKM-së 277/1997; neni 15 i ligjit 8626/2000; neni 4 i VKM-së 31/2001).

23. Në vlerësimin e Gjykatës, ky lloj përfitimi financiar, i cili i përket grupit të përfitimeve shtesë që iu paguhen të verbërve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, është i një natyre ngushtësisht personale, i patransferueshëm, i patrashëgueshëm dhe është i dallueshëm nga pagesat apo përfitimet e tjera të këtyre kategorive.

24. Gjykata çmon se këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e ushtrimit nga ana e institucioneve shtetërore ligjvënëse të së drejtës për të rregulluar ndryshe një situatë ekzistuese në varësi të kërkesave që imponon evoluimi i vazhdueshëm i shoqërisë. Kjo e drejtë reflektohet në krijimin e një kuadri normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të shoqërisë. Në çdo rast, rregullimet që i përkasin sistemit të mbrojtjes sociale të shtetit duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese, si dhe detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Europiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit. Parime të tilla, si shteti social dhe shteti i së drejtës kërkojnë që shteti, si rregullator, të vendosë kufijtë midis të mirës së përgjithshme të shoqërisë dhe të drejtave të grupeve të veçanta. Shteti duhet të niset nga trajtimi i barabartë për të gjithë dhe pastaj të kujdeset përkatësisht për kriteret e secilit grup. Ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave, duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese (*shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Mbrojtja sociale realizohet me anë të dy mekanizmave: së pari nëpërmjet zbatimit të garancive të shprehura në të drejtat dhe liritë ekonomiko-sociale (kreu IV i Kushtetutës) dhe së dyti, nëpërmjet përmbushjes së objektivave socialë, përmes materializimit të tyre në ligje, në përputhje me nenin 59 të Kushtetutës. Përmbajtja e të drejtave ekonomiko-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive, duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t’u bërë aktiv e për t’u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*shih vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Përmbushja e objektivave socialë, që shteti synon të realizojë, bëhet brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që shteti disponon.

26. Në vijim, Gjykata vlerëson se të drejtat me natyrë ekonomiko-sociale dallojnë nga objektivat sociale, pasi këto të fundit nuk kanë të bëjnë me çështje të titullaritetit ndaj shërbimeve në kuadër të mbrojtjes sociale, por janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të përcaktuara prej tij për orientimin e politikave sociale. Objektivat socialë reflektojnë veprimtarinë pozitive të shtetit në kuadrin social dhe realizimi i këtyre objektivave është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit.

27. Në çështjen konkrete, Gjykata çmon se masa e përfitimit mujor për të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët është shprehje e realizimit të mbrojtjes sociale përmes përmbushjes



së objektivave sociale, në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës. Ky përfitim nuk është element përbërës i pages, dhe as i barasvlershëm me të, ndaj si objektiv social përmbushet brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon shteti. Indeksi i pagesës mujore, për shkak të aftësisë së kufizuar, me çmimet e konsumit reflekton përshtatjen e saj me nivelin ekonomik të vendit. Situata financiare e të verbërve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, për shkak të paaftësive fizike të tyre, është veçanërisht e ekspozuar ndaj ndryshimeve të çmimeve të konsumit. Duke zgjedhur indeksin e çmimeve të konsumit, si kriter për përllogaritjen e masës së pagesës mujore, Këshilli i Ministrave ka bërë një rregullim të kësaj pagese që i shërben, para së gjithash, zbutjes së efekteve negative që mund të shkaktojë inflacioni mbi situatën financiare dhe kushtet e jetesës së këtyre personave me aftësi të kufizuar.

28. Në përfundim, për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbushja e objektivave sociale nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara për cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i ndryshimeve të mënyrës së përllogaritjes së pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar, është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/c e 134/f të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Petrit Ploçi, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës të paraqitur nga kërkuesi, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice, të cilin e kemi parashtruar edhe në vendimin nr. 34, datë 28.05.2012. Në këtë çështje, shumica ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i mënyrës së llogaritjes së pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar, është i pabazuar dhe si i tillë e ka rrëzuar. Sipas qëndrimit të shumicës, përmbushja e objektivave sociale, shprehje e së cilës është dhe përfitimi për shkak të aftësisë së kufizuar, nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Pakica, në ndryshim nga shumica, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me cenim të parimit të sigurisë juridike për arsyet që përmbledhen në vijim.

2. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore (*shih vendimin nr. 33/2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me

qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 20/2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitimë të tyre (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Pakica rithekson se parimi i sigurisë juridike bashkëvepron edhe me parime të tjera si ai i shtetit social, i cili i siguron ligjvënësit një hapësirë të gjerë dhe të papërcaktueshme saktësisht për të rregulluar përfitimin e të mirave sociale në një masë dhe sasi të caktuar (*shih vendimin nr. 10, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadrin e shtetit social reflektohet edhe detyrimi i shtetit për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuar një mbrojtje të veçantë sociale.

4. Në çështjen konkrete, pakica nënvizon se pagesa mujore është *një e drejtë e fituar* e personave të verbër, paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga legjislacioni përkatës në fuqi, me natyrë sociale dhe karakter kompensues, e cila synon garantimin e kushteve për integrimin e tyre në jetën normale. Si e tillë, për arsye që vetëkuptohen, kjo e drejtë ka një rëndësi të veçantë.

5. Mekanizmi i ri indeksues i pagesës e lidh përllogaritjen e vlerës monetare të pagesës mujore që iu takon të verbërve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve me indeksin e çmimeve të konsumit. Pakica pranon se Kushtetuta nuk ndalon çdo ndryshim të një situatë të favorshme ligjore, por megjithatë kjo nuk do të thotë se këto lloj ndryshimesh nuk mund t'i nënshtrohen kontrollit, rast pas rasti, për sa i përket kriterëve objektive mbi bazën e të cilave është bërë ndryshimi. Përpara ndryshimeve të vitit 2010 me VKM-të përkatëse, kriteri referues për përllogaritjen e pagesës ishte paga minimale, ndërsa në regjimin aktual në fuqi, kriteri i ri referues është indeksi i çmimeve të konsumit. Sipas statistikave zyrtare, indeksi i çmimeve të konsumit, i cili përbën treguesin kryesor të nivelit të inflacionit në vend, është mjaft i paqëndrueshëm dhe i luhatsëm, duke pësuar ulje - ngritje të vazhdueshme. Nga ana tjetër, paga minimale dhe ndryshimet që ajo pëson, ndikohen nga një mori faktorësh duke përfshirë, midis të tjerash, jo vetëm inflacionin në nivel kombëtar por edhe prodhimin e brendshëm bruto (PBB ose "GDP") dhe elemente të tjera të progresit social, si p.sh. kërkesat e ofertat e punësimit, kushtet e punësimit, rritjen e produktivitetit, kostot e punës, lirinë ekonomike, standardin e jetesës etj.

6. Ne mendojmë se ajo që është esenciale në rastin konkret, nuk ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së vlerës monetare të pagesës mujore, si mjet kompensues, që do të nënkuptonte dhënien nga Gjykata të një drejtësie sociale, por me vlerësimin nëse kriteret ligjore që ligjvënësi ka përcaktuar për llogaritjen e vlerës monetare të kësaj pagese janë apo nuk janë arbitrare.

7. Duke qenë se paga minimale përcaktohet mbi bazën e një sërë faktorësh ekonomikë, si kriter përllogaritës ofron më tepër stabilitet dhe qëndrueshmëri sesa indeksi i çmimeve të konsumit, që është vetëm një nga faktorët influencues në rregullimin e pagës minimale. Në vlerësimin e pakicës, indeksi i çmimeve të konsumit, për arsye të luhatjes dhe paqëndrueshmërisë që e karakterizon, mbart në vetvete arbitraritet.

8. Gjithashtu, pakica evidenton se me formulën e re në fuqi, sipas udhëzimit nr. 114, datë 4.8.2011 të Ministrisë të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke filluar nga data 1 shtator 2011, masa e përfitimit për shkak të aftësisë së kufizuar për kategoritë e të verbërve, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, është llogaritur në 9 300 lekë/muaj. Nëse kjo pagesë do të llogaritej me formulën e vjetër mbi bazën e pagës minimale shtetërore, do të ishte 70% e 19 000 (paga minimale aktuale sipas VKM nr. 566, dt. 14.07.2010), pra 13 300 lekë/muaj. Siç duket qartë, pagesa mujore për të verbërit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët ka pësuar një përkeqësim në vlerë monetare me ndryshimet ligjore, objekt shqyrtimi.

9. Nisur nga argumentet e mësipërme, pakica çmon se pretendimi i kërkuesit në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike është i bazuar dhe duhej të pranohej nga Gjykata.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Pllaçi



VENDIM
Nr. 76, datë 22.6.2012

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE SIGURIMI
PËR KLASAT E JO-JETËS**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/dh të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 31 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencim-Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “ANSIG” sh.a. për ushtrim veprimtarie sigurimi për klasat e jo-jetës, përkatësisht klasat: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 15:

- Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale);

- Klasa 2: Sigurimi i sëmundjeve;

- Klasa 3: Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina);

- Klasa 5: Sigurimi i avionëve;

- Klasa 6: Sigurimi i anijeve;

- Klasa 7: Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve);

- Klasa 8: Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës;

- Klasa 9: Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 5, 6 dhe 7);

- Klasa 10: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësinë e transportuesit);

- Klasa 11: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësinë e transportuesit);

- Klasa 12: Sigurimi i përgjegjësisë civile nga përdorimi i anijeve (detare, të liqeneve dhe të lumejve, si dhe ato të kanaleve, përfshirë përgjegjësinë e transportuesit);

- Klasa 13: Sigurimi i përgjegjësisë civile të përgjithshme, përveç atyre të përmendura në klasat 10, 11 dhe 12;

- Klasa 15: Sigurimi i garancive.”

2. Licenca jepet për një periudhë pa afat.

3. Ngarkohet departamenti përkatës për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Enkeleda Shehi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.7.2012
Doli nga shtypi më 2.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 18 lekë